



P Z A P  
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.177/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët; Arsim Hamzaj kryesues, Kymete Kicaj, dhe Skender Çocaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik, Lidhja Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Subjektit Politik, Demokracia Serbe (DS), me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 26.01.2025, merr këtë,

#### V E N D I M

I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.177/2025, e datë 24.01.2025.

II. Subjektit Politik Demokracia Serbe (DS), me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënim i gjelbëri më lartësi prej 4.000.00, (katërmijë e pesëqind) €uro.

III. Detyrohet Subjektit Politik Demokracia Serbe (DS) me seli në Mitrovicën e Veriut, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

#### A r s y e t i m

Me datë 23.01.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën A.nr.177/2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, të paraqitur kundër subjektit politik, Demokracia Serbe (DS), me seli në Mitrovicë të Veriut, në të cilën pretendon se aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje në Mitrovicën e Veriut kanë identifikuar banerë/poster të vendosur në hapësirat/rrugët publike, të kandidatit për deputet të subjektit politik, Demokracia Serbe (DS), Aleksander Arsinijovic, në Leposaviq, dhe se më të njëjtin veprim kandidati dhe subjekti politik, Demokracia Serbe (DS), ka bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP, konkretisht nen 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i LZP-së parasheh: "Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalojnë nga bërja e ndonjëritës si në vijim: 1.2 vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna

*ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve.”* Parashtruesi i ankesës ka theksuar se për më shumë çështje të natyrës së njëjte, tashmë PZAP, ka praktikë të vendosjes përmes vendimit Anr.79/2025, të datës;22.01.2025, dhe vendime tjera përkatëse. Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografi që dëshmon vendosjen e banerit/posterit në kundërshtim me LZP.

Më datë 24.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik ,Demokracia Serbe (DS), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë përgjigje deri me datë;25.01.2025.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë;25.01.2025, subjekti politik, Demokracia Serbe, ka kundërshtuar ankesën e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje duke theksuar se Demokracia Serbe ka marr pëlqim nga pronarët e ndërtesave dhe strukturave për të vendosur posterat në ndërtesat e tyre dhe në këtë drejtim Demokracia Serbe nuk ka shkelur nenin që pretendon Lëvizja Vetëvendosje, përkatësisht, nenin 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Po ashtu në përgjigje në ankesë subjekti politik Demokracia Serbe ka theksuar se nëse është e nevojshme Demokracia Serbe do ti sigurojë PZAP-së numrat e telefonit të përfaqësuesve të këshillit të banorëve për të gjitha ndërtesat në të cilat kemi vendosur posterat në rrugët e përmendura në Mitrovicën e Veriut në momentin që Lëvizja Vetëvendosje na ofron adresat e sakta të ndërtesave për të cilat u ankua. Në përgjigje ne ankesë theksohet se Demokracia Serbe nuk ka shkelur nenin 7, paragrafi 2.6 dhe ka marr pëlqimin e përfaqësuesve të këshillit të banorëve në të gjitha rrugët ku kemi ngjitur materiale promovuese, gjithashtu në ankesën e paraqitur nga Lëvizja Vetëvendosje nuk janë të qarta lokacionet e sakta te objekteve, përkatësisht numrat e të gjitha objekteve dhe ndërtesave që Lëvizjes Vetëvendosje konsideron se janë ngjitur në mënyrë jo të rregullt posterat e subjektit të tyre politik. Mëtutje në përgjigje theksohet subjekti i tyre politik iu është drejtuar Komisionit Komunal Zgjedhor në Mitrovicën e Veriut, ku kanë kërkuar që të kontrollojnë dhe ti informojnë për gabimet e mundshme gjatë ngjitetës së posterëve në mënyrë që ti heqin posterat në kohën e duhur, por deri sot nuk kanë marrë asnje njoftim prej tyre.

PZAP, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën, vëren se:

- *Ankesa është e bazuar.*

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik Demokracia Serbe, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LVV, janë të qëndrueshme dhe të bazuara, dhe si të tilla i aprovoj, përfaktin se veprimet e përshkruara në ankesë paraqesin shkelje nga ana e subjektit politik Demokracia Serbe, ngase e njëjta ka vendosur posterët në hapësirat publike/ rrugë publike, të kandidatit të tyre për deputet, Aleksander Arsenijovic, përkatësisht në Leposaviq, më të cilat iu bënë thirrje qytetarëve për votimin e subjektit politik, Demokracia Serbe për procesin zgjedhor që do të mbahet me datë 09.02.2025, ku me këto veprime ka shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se “*Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.*”

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes, dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përbën shkelje për herë të parë të legjislacionit zgjedhor. Po ashtu, Subjekti Politik, Demokracia Serbe, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj vendosja e posterëve-njoftimeve të kandidatit për deputet të subjektit të tyre politik për fushatë zgjedhore në hapësirat publike/ rrugë publike në Leposaviq, përbën shkelje të legjislacionit zgjedhor, dhe të njëjtë shkelje janë sanksionuar me dispozitat ligjore të LZP-së.

Subjekti Politik, Demokracia Serbe në përgjigje në ankesë ka kundërshtuar ankesën e parashtuesit duke theksuar se posteri e kandidatit për deputet nga radhët Subjekti Politik, Demokracia Serbe, Aleksander Arenijevic dhe kandidatëve të tjerë janë vendosur me pëlqim të banorëve të objekteve banesore të cilët kanë dhënë pëlqimin paraprak për vendosjen e tyre. Për Panelin këto pretendime janë të pa bazuar, përfaktin se posteret janë vendosur në hapësirën publike/ rrugë publike, dhe se përfaktë raste duhet leje e veçantë, përkatesisht, pëlqim nga Drejtoria përkatëse të lëshuar nga Komuna e Leposaviqit. Kurse në rastet kur objektet janë private, atëherë duhet të sigurohet pëlqimi me shkrim nga pronari-shfrytëzuesi të objektit.


Paneli po ashtu vlerësoi edhe pretendimet tjera nga përgjigja në ankesë, mirëpo të njëjtat i vlerësoi si të pa bazuara, përfaktin se të njëjtat nuk janë provuar me asnjë prove të vetme.

Prandaj, duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “*vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tillë të palës ankuese janë të qëndrueshme dhe si të tillë i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokratisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e pëershkuara në ankesë nga parashtuesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi si të bazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, nenin 118 paragrafi 1, dhe nenin 120 paragrafi 1 nen parafi 1.3, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Anr.177/2025, datë: 26.01.2025

Kryesues i Panelit  
Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së.